



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0432

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së OE MIMOZA 1985 SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me lule dhe kurora” me numër të prokurimit 632-26-3086-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS, më 05/08/2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, pjesërisht e bazuar ankesa e MIMOZA 1985 SH.P.K. me nr. 2026/0432 , e datës 26/06/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me lule dhe kurora”, me numër të prokurimit 632-26-3086-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KOMUNA E GJAKOVËS.
2. Anulohet në tërësi, në munges të ofertave të përgjegjshme, aktiviteti i prokurimit “Furnizim me lule dhe kurora”, me numër të prokurimit 632-26-3086-1-2-1.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore sipas paragrafi 4, dhe 6 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 05.05.2026. KOMUNA E GJAKOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me lule dhe kurora” me nr. të prokurimit: "632-26-3086-1-2-1"

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrates: 30,000. €.

Me 12.06.2026 KOMUNA E GJAKOVËS, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Bletaria Egzoni”.

Me 16.06.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 18.06.2026 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 26.06.2026, OE “MIMOZA 1985 SH.P.K” ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0432, kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “MIMOZA 1985 SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, në veçanti:

Parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të operatorëve ekonomikë;

Parimin e transparencës dhe konkurrencës së ndershme;

Dispozitat e LPP-së që obligojnë Autoritetin Kontraktues të bëjë verifikimin e plotë të përmbushjes së kriterëve të kualifikimit të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar operatorin ekonomik për kontratë pa dhënë arsyetim të mjaftueshëm lidhur me përmbushjen e kriterëve të përshtatshmërisë profesionale, kapacitetit teknik dhe profesional, si dhe pa iu përgjigjur pretendimeve tona të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim.

A N K E S Ë

Ankuesi: Operatori Ekonomik "MIMOZA 1985" SH.P.K. me NUI 812202993, përfaqësuar nga pronari Genc Reznqi.

Kundër: Vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjakovës, datë 18.06.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim.

Lënda: Ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me lule dhe kurora", Nr. i Prokurimit 632-26-3086-1-2-1.

A r s y e t i m

Brenda afatit ligjor paraqesim këtë ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 18.06.2026, pasi i njëjti është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, Dosjen e Tenderit dhe parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së ndershme. Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim pa shqyrtuar në mënyrë të plotë dhe objektive pretendimet tona lidhur me operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë, duke u mjaftuar vetëm me konstatimin se oferta jonë nuk ka qenë oferta me çmimin më të ulët dhe se nuk kemi plotësuar një pjesë të dokumentacionit lidhur me referencat. Një arsyetim i tillë është i pamjaftueshëm dhe nuk u përgjigjet fare pretendimeve tona thelbësore.

Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim ligjor që, para marrjes së vendimit për dhënien e kontratës, të bëjë verifikimin e plotë të përmbushjes së të gjitha kriterëve të kualifikimit nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë. Kjo rezulton edhe nga vetë Dosja e Tenderit, ku kërkohet që operatorët ekonomikë të përmbushin kriteret e përshtatshmërisë profesionale dhe të dëshmojnë regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial apo të ndërmarrjeve, si dhe të dëshmojnë kapacitetin teknik dhe profesional përmes kontratave të natyrës së ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit.

Mirëpo, nga Certifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe ekstrakti zyrtar i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), të cilat i bashkëngjiten kësaj anekse, rezulton se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ushtron veprimtari ekonomike nën emrin tregtar "N.T.P. Bletaria Egzoni", ndërsa aktivitetet e regjistruara të tij lidhen me rritjen e kafshëve, përpunimin e ushqimit për kafshë, prodhimin dhe përpunimin e produkteve të drurit, tregtinë me shumicë të makinerive bujqësore, transportin rrugor të mallrave dhe veprimtari të tjera të kësaj natyre. Në asnjërin prej aktiviteteve ekonomike të regjistruara nuk figuron furnizimi me lule, tregtia me lule, përgatitja e kurorave, dekorimet floristike apo ndonjë aktivitet tjetër që lidhet drejtpërdrejt me objektin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Në këto rrethana lindin dyshime serioze dhe të bazuara se operatori ekonomik i rekomanduar nuk e përmbush kriterin e përshtatshmërisë profesionale dhe nuk posedon kapacitetin e nevojshëm profesional për realizimin e kontratës. Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim se si ka konstatuar se ky operator ekonomik i përmbush kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, nuk ka sqaruar nëse ka verifikuar aktivitetin ekonomik të tij dhe nuk ka administruar asnjë provë që dëshmon se operatori fitues ushtron veprimtarinë për të cilën është zhvilluar ky aktivitet i prokurimit.

Për më tepër, Dosja e Tenderit kërkon që operatori ekonomik të dëshmojë se gjatë tre viteve të fundit ka realizuar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, duke paraqitur listën e kontratave, referencat përkatëse, certifikatat e pranimit apo raportet e ekzekutimit të mirë të furnizimeve, ndërsa për kontratat me sektorin privat kërkohen edhe transaksionet bankare përkatëse. Duke pasur parasysh se operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka të regjistruar aktivitet ekonomik që lidhet me furnizimin me lule dhe kurora, ekzistojnë dyshime serioze edhe për faktin nëse ai ka qenë në gjendje të përmbushë këtë kriter të rëndësishëm të Dosjes së Tenderit. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me këtë çështje dhe nuk ka sqaruar se cilat kontrata, referenca apo dëshmi janë pranuar si të rregullta.

Vendimi i kundërshtuar nuk përmban asnjë analizë lidhur me pretendimet tona, nuk përmban arsyetim mbi ligjshmërinë e kualifikimit të operatorit fitues dhe nuk tregon se mbi cilat prova është mbështetur Autoriteti Kontraktues për të konstatuar se operatori ekonomik i rekomanduar

për kontratë i plotëson të gjitha kriteret e Dosjes së Tenderit. Një vendim administrativ duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë të plotë dhe tu përgjigjet të gjitha pretendimeve të palëve, ndërsa mosdhënia e përgjigjes për pretendimet tona përbën shkelje të parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk mund të mbështetet vetëm në faktin se një operator ekonomik ka ofruar çmimin më të ulët, nëse paraprakisht nuk është vërtetuar se ai operator i plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe profesionale për realizimin e kontratës. Përzgjedhja e një operatori ekonomik që nuk ushtron veprimtarinë ekonomike që përbën objektin e kontratës, pa u bërë verifikimi i plotë i dokumentacionit dhe kapaciteteve të tij profesionale, cenon rëndë parimet e konkurrencës së ndershme, trajtimit të barabartë dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Nga të gjitha rrethanat e lartcekura rezulton se Vendimi i Autoritetit Kontraktues është i paarsyetuar, i nxjerrë me vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit, për rrjedhojë, i njëjti duhet të anulohet.

PROPOZIM

Andaj, duke u bazuar në faktet, provat dhe argumentet juridike të paraqitura më lart, propozojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit të nxjerrë këtë:

VENDIM

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik "MIMOZA 1985" SH.P.K.;
2. Anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 18.06.2026, si dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës;
3. Obligohet Autoriteti Kontraktues që të bëjë rivlerësimin e ofertave në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Dosjen e Tenderit;
4. Obligohet Autoriteti Kontraktues që gjatë rivlerësimit të bëjë verifikimin e plotë të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, duke shqyrtuar aktivitetin e tij ekonomik, përshtatshmërinë profesionale, kapacitetin teknik dhe profesional, kontratat e natyrës së ngjashme, referencat, raportet e pranimi, certifikatat e ekzekutimit të mirë, si dhe vërtetësinë dhe ligjshmërinë e të gjithë dokumentacionit të paraqitur në ofertë;
5. Në rast se konstatohet se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit ose nuk përmbush kushtet e Ligjit për Prokurimin Publik, i njëjti të eliminohet nga procedura e prokurimit dhe procedura të vazhdojë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Operatori Ekonomik "MIMOZA 1985" SH.P.K., me dt.17.06.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Fumizim me lule dhe kurora", Nr. i prokurimit-632-26-3086-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-26-014-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 18.06.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fialë si më poshtë:

Pretendimet ejuajajanë të pabazuara sepse:

-Autoriteti kontraktues ka shpërblyer me kontratë Operatorin ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

-Ju si Operator ekonomik nuk keni prezantuar listën e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha furnizimet e realizuara në 3 (tre) vitet e shkuara, duke saktësuar furnizimet e kryera shumë e kontratës, datën e pranuesit ose cefifikatën e ekzekutimit të mirë të furnizimeve- (së paku një referencë ose raport të pranimi të furnizimeve e cila përputhet me listën e dorëzuar) dhe keni pasur çmimin më të lartë, duke mos plotësuar kështu kërkesat e Autoritetit Kontraktues siç është kërkuar në FDT, për çka edhe jeni eliminuar;

-Qasja në dokumentacion fillon menjëherë pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit kontraktues(neni 7 paragrafi 7.2 i Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr, 002/2024), ku çdo Operator ekonomik mund të kërkoj qasje brenda afatit ligjor(neni 60, paragrafi 60.1 nën b) i rregullores), e jo kërkesa për qasje të dorëzohet bashkë me kërkesën për rishqyrtim siç keni vepruarju;

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me date 29.06.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0432, ndërsa me datë 10.07.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0432, me rekomandimet si në vijim:
Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rreth rekomandimit të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu as OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dheparashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrësas dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “MIMOZA 1985 SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0432 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr. 1

Pretendimi i parë ankimor sipas ankesës 432/26 është se OE nuk e ka kthyer përgjigjen/vendimin në kërkesë për rishqyrtim në pajtim me dispozitat e LPP-së, pasi AK nuk është përgjigjur në pretendimet ankimore të parashtruara kundrejt OE të rekomanduar për kontratë.

OE ankues në ankesën e tij ndër të tjera deklaroi se:

“Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën tonë për rishqyrtim pa shqyrtuar në mënyrë të plotë dhe objektive pretendimet tona lidhur me operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë, duke u mjaftuar vetëm me konstatimin se oferta jonë nuk ka qenë oferta me çmimin më të ulët dhe se nuk kemi plotësuar një pjesë të dokumentacionit lidhur me referencat. Një arsyetim i tillë është i pamjaftueshëm dhe nuk u përgjigjet fare pretendimeve tona thelbësore.

Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim ligjor që para marrjes së vendimit për dhënien e kontratës të bëjë verifikimin e plotë të përmbushjes së të gjitha kriterëve të kualifikimit nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë. Kjo rezultoi edhe nga vetë Dosja e Tenderit, ku kërkohej që operatorët ekonomikë të përmbushin kriteret e përshtatshmërisë profesionale dhe të dëshmojnë regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial apo të ndërmarrjeve, si dhe të dëshmojnë kapacitetin teknik dhe profesional përmes kontratave të natyrës së ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit.

Mirëpo, nga Certifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe ekstrakti zyrtar i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), të cilat i bashkëngjiten kësaj ankese, rezultoi se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ushtron veprimtari ekonomike nën emrin tregtar "N.T.P. Bletaria Egzoni", ndërsa aktivitetet e regjistruara të tij lidhen me rritjen e kafshëve, përpunimin e ushqimit për kafshë, prodhimin dhe përpunimin e produkteve të drurit, tregtinë me shumicë të makinerive bujqësore, transportin rrugor të mallrave dhe veprimtari të tjera të kësaj natyre. Në asnjërin prej aktiviteteve ekonomike të regjistruara nuk figuron furnizimi me lule, tregtia me lule, përgatitja e kurorave, dekorimet floristike apo ndonjë aktivitet tjetër që lidhet drejtpërdrejt me objektin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Në këto rrethana lindin dyshime serioze dhe të bazuara se operatori ekonomik i rekomanduar nuk e përmbush kriterin e përshtatshmërisë profesionale dhe nuk posedon kapacitetin e nevojshëm profesional për realizimin e kontratës. Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim se si ka konstatuar se ky operator ekonomik i përmbush kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit, nuk ka sqaruar nëse ka verifikuar aktivitetin ekonomik të tij dhe nuk ka administruar asnjë provë që dëshmon se operatori fitues ushtron veprimtarinë për të cilën është zhvilluar ky aktivitet i prokurimit.

Për më tepër, Dosja e Tenderit kërkon që operatori ekonomik të dëshmojë se gjatë tre viteve të fundit ka realizuar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, duke paraqitur listën e kontratave, referencat përkatëse, certifikatat e pranimit apo raportet e ekzekutimit të mirë të furnizimeve, ndërsa për kontratat me sektorin privat kërkohej edhe transaksionet bankare përkatëse. Duke pasur parasysh se operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka të regjistruar aktivitet ekonomik që lidhet me furnizimin me lule dhe kurora, ekzistojnë dyshime serioze edhe për faktin nëse ai ka qenë në gjendje të përmbushë këtë kriter të rëndësishëm të Dosjes së Tenderit. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim lidhur me këtë çështje dhe nuk ka sqaruar se cilat kontrata, referenca apo dëshmi janë pranuar si të rregullta.

Vendimi i kundërshtuar nuk përmban asnjë analizë lidhur me pretendimet tona, nuk përmban arsyetim mbi ligjshmërinë e kualifikimit të operatorit fitues dhe nuk tregon se mbi cilat prova është mbështetur Autoriteti Kontraktues për të konstatuar se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë i plotëson të gjitha kriteret e Dosjes së Tenderit. Një vendim administrativ duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë të plotë dhe tu përgjigjet të gjitha pretendimeve të palëve, ndërsa

mosdhënia e përgjigjes për pretendimet tona përbën shkelje të parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk mund të mbështetet vetëm në faktin se një operator ekonomik ka ofruar çmimin më të ulët, nëse paraprakisht nuk është vërtetuar se ai operator i plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe profesionale për realizimin e kontratës.

Përzgjedhja e një operatori ekonomik që nuk ushtron veprimtarinë ekonomike që përbën objektin e kontratës, pa u bërë verifikimi i plotë i dokumentacionit dhe kapaciteteve të tij profesionale, cenon rëndë parimet e konkurrencës së ndershme, trajtimit të barabartë dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

PROPOZIM

Andaj, duke u bazuar në faktet, provat dhe argumentet juridike të paraqitura më lart, propozojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit të nxjerrë këtë:

VENDIM

Aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik "MIMOZA 1985" SH.P.K.;

Anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 18.06.2026, si dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien e kontratës;

Obligohet Autoriteti Kontraktues që të bëjë rivlerësimin e ofertave në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Dosjen e Tenderit;

Obligohet Autoriteti Kontraktues që gjatë rivlerësimit të bëjë verifikimin e plotë të operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, duke shqyrtuar aktivitetin e tij ekonomik, përshtatshmërinë profesionale, kapacitetin teknik dhe profesional, kontratat e natyrës së ngjashme, referencat, raportet e pranimit, certifikatat e ekzekutimit të mirë, si dhe vërtetësinë dhe ligjshmërinë e të gjithë dokumentacionit të paraqitur në ofertë;

Në rast se konstatohet se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit ose nuk përmbush kushtet e Ligjit për Prokurimin Publik, i njëjti të eliminohet nga procedura e prokurimit dhe procedura të vazhdojë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.”

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të shkresave të lëndës, kërkesës për rishqyrtim dhe vendimit të AK-së në kërkesë për rishqyrtim, ka gjetur se AK nuk e ka nxjerrë vendimin e tij në bazë të asaj çka është kërkuar nga ankuesi, siç parashihet me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së.

Megjithatë, AK në arsyetimin e kërkesës për rishqyrtim thekson se:

“Ju si Operator Ekonomik nuk keni prezantuar listën e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha furnizimet e realizuara në 3 (tre) vitet e shkuara, duke saktësuar furnizimet e kryera, shumën e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mirë të furnizimeve (së paku një referencë ose raport të pranimit të furnizimeve, e cila përputhet me listën e dorëzuar), dhe keni pasur çmimin më të lartë, duke mos plotësuar kështu kërkesat e Autoritetit Kontraktues, siç është kërkuar në FDT, për çka edhe jeni eliminuar.”

Eksperti shqyrtues, pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se OE ankues as në kërkesë për rishqyrtim, e as përmes ankesës në OSHP nuk tenton të argumentojë se arsyet e AK-së për eliminimin e tij janë të pabazuara!

Në këto rrethana, kërkesa e OE për rivlerësim nuk do të sillte ndryshim në rezultat sa i përket shpalljes të papërgjegjshëm të vetë OE ankues. Duke pasur parasysh se OE i rekomanduar për kontratë është me çmim më të ulët se OE ankues, duke pasur parasysh vlerën relativisht të ulët të këtij aktiviteti të prokurimit dhe qëllimin e procedurave të prokurimit që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, atëherë mendimi i ekspertit është që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkëlqjeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në këtë rast.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, veprimeve të ndërmarra nga palët, deklaratave të tyre, si dhe provave të administruara gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në nenin 10 paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik si dhe nenin 7 paragrafi 7.6.3 të RrPP-së , duke mos i mundësuar Operatorit Ekonomik ankues qasje në versionin e pastruar të dokumentacionit, ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi.

Më tej, Paneli Shqyrtues, pas analizimit të dokumentacionit të administruar dhe vlerësimit të provave të paraqitura në këtë procedurë, ka shqyrtuar përmbushjen e kërkesës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues në pikën III.2.4 – Kapaciteti teknik dhe profesional, sipas së cilës është kërkuar që Operatori Ekonomik të dëshmojë se gjatë tri (3) viteve të fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, ka përfunduar me sukses kontrata që dëshmojnë realizimin e furnizimeve të natyrës së ngjashme dhe si dëshmi dokumentare, është kërkuar: “Lista e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha furnizimet e realizuara në 3 (tre) vitet e shkuara,

duke saktësuar furnizimet e kryera shumë e kontratës, datën e pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit të mirë të furnizimeve – (së paku një referencë ose raport të pranimit të furnizimeve e cila përputhet me listën e dorëzuar), në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me Operator Ekonomik privat atëherë Operatori Ekonomik duhet të prezanton transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë-referencë.”

Paneli Shqyrtues analizoj ofertën e OE të rekomanduar për kontrate nga AK-ja dhe nga analiza e listës së kontratave dhe referencave të dorëzuara konstaton se pjesa dërrmuese e furnizimeve të realizuara lidhen me sektorin e bletarisë dhe bujqësisë, përfshirë furnizimin me koshere, bletë, dyll, pajisje për bletari, centrifuga për nxjerrjen e mjaltit, mekanizëm bujqësor dhe pajisje për shpezëtarë. Këto furnizime, sipas vlerësimit të Panelit, nuk mund të konsiderohen si furnizime të natyrës së ngjashme me objektin e këtij aktiviteti të prokurimit, përkatësisht me furnizimin e artikujve të paraparë në paramasë dhe në Dosjen e Tenderit.

Për rrjedhojë, Paneli Shqyrtues vlerëson se Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk ka dëshmuar në mënyrë bindëse përmbushjen e kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Njoftim për kontrate dhe Dosjen e Tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha gjetjet e konstatuara gjatë shqyrtimit të kësaj procedure, Paneli Shqyrtues nuk mund ta mbështesë konstatimin dhe rekomandimin e dhënë në raportin e ekspertit shqyrtues në këtë pjesë, ndërsa vendos që ankesa e Operatorit Ekonomik të aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues mbështetur në nenin 1 dhe 7 të LPP-se, ka vendosur ta anuloj në tersi procedurën në mungesë të ofertave të përgjegjshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : Furnizim me lule dhe kurora, me nr 632-26-3086-1-2-1, nëse nuk ka ankesa tjera në këtë procedurë.

Poashtu, Paneli Shqyrtues vuri re edhe korigjimin e procedures sipas rekomandimit të KRPP-se, dhe nëse ka interesim për ritenderim duhet të sigurohet tek kushtet e veçanta të kontratës që për zgjidhjen e mos marveshjes ku është vendosur në mes të palëve se kush është saktësisht a është Komisioni për ndërmjetim pranë Ministrisë së Drejtësisë ?.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - MIMOZA 1985 SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: